VENDIM
Nr.70, datë 24.6.2008

PËR MIRATIMIN E LICENCËS SË AKTIVITETIT TË FURNIZIMIT PUBLIK ME SHUMICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1, germa "ç", dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.39, datë 21.3.2008 "Për fillimin e procedurave për miratimin e licencës së furnizimit publik me shumicë të energjisë elektrike, licencës së shpërndarjes së energjisë elektrike dhe licencës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.6.2008, pasi shqyrtoi dhe analizoi draftin e licencës së aktivitetit të furnizimit publik me shumicë të energjisë elektrike të përgatitur nga grupi i punës i ngritur për këtë qëllim,

VENDOSI:

1. Miratimin e licencës së aktivitetit të furnizimit publik me shumicë të energjisë elektrike (licenca bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta